



DATË:	10.07.2022
REFERENC-Ë:	09-zyrtare
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Drejtoria për Shërbime Publike- z. Shkumbin Kastrati
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë mbi implementimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2025

Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave

Gjatë periudhës Janar-Tetor 2022 janë Implementuar objektivat të cilat rrjedhin nga Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave si në vijim:

Objektiva 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave:

1.1: Riorganizimi dhe plotësimi me shërbim të grumbullimit të mbeturinave në zonat ku ofrohet pjesërisht ky shërbim me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme.
(I Realizuar –Proces i vazhdueshëm)

1.2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë territorin e komunës së Gjakovës me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2021, (I Realizuar).

1.3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave. (I Realizuar 2020/21 –Proces i vazhdueshëm)

Nga 3 qëllimet e parapara në PLMM janë realizuar 1 tërësisht kurse 2 janë në procese të vazhdueshme.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Postal address: Nëna Tereze nr.469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-050

kk.rks-gov.net/gjakove/

Objektiva 2 : Zhvillimi i sistemeve për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi:

2.1. Zbatimi i masave për rehabilitim të plotë të ST-së sipas standardeve për grumbullim provizor të mbeturinave dhe dërgimin e tërësishëm të tyre në deponi **(Në Proces)**.

2.2. Zbatimi i masave për funksionalizimin e ST-së për zhvillimin e aktiviteteve të ndarjes në burim të mbeturinave **(I Përfunduar)**.

2.3: Nxitjen e iniciativave për minimizimin e mbeturinave përmes stimulimit të grumbullimit të diferencuar në dy fraksione (të riciklueshme dhe jo të riciklueshme) **(Në Proces)**.

2.5: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit shtëpiak. **(Në Proces)**.

Nga 5 qëllime e parapara në PLMM janë realizuar 1 tërësisht kurse 3 janë në procese të Vazhdueshme.

Objektiva 3: Aplikimi i skemave për grumbullimin, transportimin dhe ndarjen e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimin të sasisë që përfundon në deponi.

3.1: Grumbullimi dhe transportimi në formë të veçantë i mbeturinave shtazore. **(Niveli Qendror)**

3.2: Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave medicinale **(Niveli Qendror)**.

3.3: Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave ndërtimore; **(Në Proces)**.

3.4: Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave të vëllimshme (**2020- Në Vazhdim**).

3.5: Pastrimi/eliminimi i sigurtë i deponive ilegale në territorin e Komunës dhe rehabilitimi i vendpozitimeve **(2021 janë pastruar 13 deponi ilegale – proces në Vazhdimësi)**.

Nga 5 qëllimet e parapara në Objektiven 3, 2 janë kompetencë e nivelit qendror kurse 3 të tjera janë procese që vazhdojnë .

Objektiva 4 : Zhvillimi i Reformave administrative në sektorin e menaxhimit të mbeturinave:

4.1 Plotësimi i strukturës me burime njerëzore brenda sektorit për menaxhim të mbeturinave; **(Në Proces)**

4.2 Plotësimi dhe miratimi i rregullores për menaxhim të mbeturinave sipas planifikimeve në sektor **(i përfunduar 2021)**.

Nga 2 qëllimet e parapara në Objektiven 4 një është realizuar kurse një nuk është në kompetencë direkte të sektorit për MM.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Postal address: Nëna Tereze nr.469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-050

kk.rks-gov.net/gjakove/

Objektiva 5 : Vetëdijesimi qytetar dhe edukimi:

*5.1: Zhvillimi i kampanjës për vetëdijesim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave;
(i realizuar - në proces)*

- Gara për Gjakovë të pastër.
- Fushatë derë në derë në 78 biznese me qëllim informimin për ndarjen në burim.
- Fushatë derë në derë në 280 ekonomi familjare me qëllim ndarjen në burim.
- Fushatë derë në derë në 3 fshatra dhe dy lagje në qytet me qëllim informimi për kompostim Shtëpiak..
- Fushatë informimi në institucionet komunale arsimore.
- Fushatë informimi në institucionet komunale shëndetësore.

Spektori për menaxhimin e mbeturinave në vazhdimësi zhvillon kampanja vetëdijesuese përmes zyrtarëve të sektorit si dhe në bashkëpunim me OJQ të cilat kanë orientim ruajtjen e ambientit.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Postal address: Nënë Tereze nr.469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390-320-050

kk.rks-gov.net/gjakove/